

VENDIM
Nr.1434, datë 29.10.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I QENDRËS SË RE KOMBËTARE DISPEÇER, I ZYRAVE TË REJA TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (OST) SHA DHE I DISPEÇERISË QENDRORE, KASHAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i Qendrës së re Kombëtare Dispeçer, i zyrave të reja të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., Tiranë dhe Dispeçerisë Qendrore, në Kashar, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të OST sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 20 935 (njëzet mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë) m², tokë bujqësore/arë, vlerësuar në shumën e përgjithshme 52 487 020 (pesëdhjetë e dy milionë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e njëzet) lekë.

4. Fondi prej 52 487 020 (pesëdhjetë e dy milionë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e njëzet) lekësh të përballohet nga fondet e OST sh.a., zëri “Kosto vendore për shpronësimet”.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit, në shumën 165 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohet nga OST sha-ja, si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.

6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit shtator dhe të përfundojë brenda muajit dhjetor 2008.

7. Mënyra e pagesës të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999.

8. Punimet për ndërtimin e Qendrës së re Kombëtare Dispeçer, të zyrave të reja të OST sh.a., Tiranë dhe të Dispeçerisë Qendrore, në Kashar, të përfundojnë brenda muajit dhjetor 2009.

9. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe OST sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË “NDËRTIMIT TË QENDRËS
SË RE KOMBËTARE DISPEÇER DHE ZYRAT E REJA TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT DHE DISPEÇERISË QENDRORE, KASHAR”**

Rrethi: Tiranë
Komuna: Kashar

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: arë

SHPRONËSIMI DEFINITIV											
Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr.i pasurisë	Sip.e shpron. në m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e kulturës bujq.	Vlera në lekë	Adresa
1	Isuf	Adem	Sula	Arë	2105	1/16	6060	2500	42420	15192420	Kashar, Tiranë
2	Jemin	Adem	Sula	Arë	2105	1/17	14875	2500	107100	37294600	Kashar, Tiranë
Shuma							20 935			52487020	

Shpenzimet procedurale konsistojnë në:

1. Publikimi në 2 gazeta me shpërndarje kombëtare: “Koha Jonë” dhe “Standard”, për një periudhë njëjavore për çdo publikim, të cilat kapin vlerën 140 000 (njëqind e dyzet mijë) lekë.

2. Bazuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.126, datë 23.3.2000 “Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të komisionit, të posaçëm të shpronësimit”, është parashikuar një masë shpërblimi për 5 anëtarët e komisionit, në vlerë totale prej 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekësh.

3. Totali i shpenzimeve të kryera nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, por që realisht do të mbulohen nga “OST” sh.a.,Tiranë, si subjekt kërkues për këtë shpronësim, janë në vlerën totale 165 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.